

ISHP

NR. 2/2001

**BULLETIN
INSTITUTE OF
SHENDETIT PUBLIK**

**INSTITUTE OF
PUBLIC HEALTH
BULLETIN**

IPH

Bordi publikues

Silva BINO	Drejtore
Alban YLLI	Shef i Sektorit të Koordinimit
Eduard KAKARRIQI	Shef i Dep. të Epidemiologjisë
Minella PAPAJORGJI	Shef i Dep. të Mikrobiologjisë
Qeramedin KODRA	Shef i Dep. të Mjedisit dhe Shëndetit
Besa BUDO	Shefe e Sektorit te Botimeve
Gledjona TOLA	Koordinatore e Buletinit

*Adresa: Institut i Shëndetit Publik
Rr. Aleksandër Moisiu Nr. 80
Tiranë ALBANIA
Tel/Fax 00355 43 700 58/59
Email: iphealth@sanx.net*

Publikimi i Buletinit të Institutit të Shëndetit Publik
u sponsorizua nga OBSh/MH (WHO/HO) dhe
Ministria Shëndetësisë, Tiranë

PERMBAJTJA

1. Survejanca Alert e 20 javëve t137 para te vitit 2001.
Dritan Ulqinaku , Miranda Ajdini Faqe 5 - 10
2. Mbi disa probleme higjeno – sanitare të ujit të pijshëm gjatë vitit 2000.
Valbona Bara , Ekuel Jella Faqe 11 – 15
3. Informacion mbi cilësinë e ajrit në Shqipëri.
Qeramedin Kodra , Agron Deliu Faqe 16 – 29
4. Epidemja e gripit në Shqipëri ne vitin 2000, shkaktari dhe përhapja e tij.
Bujar Brahimaj , Alma Robo Faqe 30 - 34
5. Studim mbi vlerësimin e metodave bashkëkohore serodiagnostikuese të sifilizit.
Minella Papajorgji , Mirela Cekani Faqe 35 – 39
6. Sigurimi dhe Kontrolli i Cilësisë në laboratoret mikrobiologjike dhe kimike të DSHP te rrëtheve.
Fejzi Hizmo , Damiana Osmalli Faqe 40 – 41
7. Liçencimi dhe inspektimi i pajisjeve diagnostikuese të rrezatimit X.
Rustem Paci Faqe 42 – 43
8. Vendosja e fëmijës në “FOKUS” ideja thelbësore e Departamentit të Shëndetit mendor të fëmijës.
Elida Canconji Faqe 44 – 46
9. Summary of the articles.
Lluka Qafoku Page/Faqe 47 - 51

SURVEJANCA ALERT E 20 JAVEVE TE PARA TE VITIT 2001

Dritan Ulqinaku, Miranda Ajdini

Ne vazhden e analizave periodike javore dhe mujore vjen dhe kjo analize e 20 javeve te para te vitit 2001 qe i korrespondon periudhes prej 01 Janarit deri me 20 Maj te ketij viti.

Sistemi i informacionit te semundjeve ngjitese me baze ne sindromat persoi nje ndryshim ne fund te vitit 2000 dhe qe gjeti zbatim ne kete vit.


Ndryshimet kane te bejne me teper ne evidentimin me te sakte dhe me real te ketyre sindromave qe pasqyrohen ne formularin "ALERT", rrjedhimisht u hoqen nga ky formular disa sindroma qe nuk arriten te pasqyrojnë siç duhet realitetin aktual, si dhe u bene disa plotesime dhe saktesime ne menyren qe ne te llogarisim me mire incidencen e ketyre sindromave ne shkalle vendi apo rrjeti.

Per te njejtën arsyen ne formularin aktual ne kemi edhe numrin e mjekeve qe duhet te raportojne si dhe numrin e mjekeve qe kane raportuar.

Si nje sistem kompleks, ne kete analize do te permendim menyren e raportimit, perqindjet e rretheve qe raportojne per javet qe kemi marre ne analize, perqindjet e qendrave shendetesore per çdo jave si dhe analizen e te dhenave te grumbulluar deri tanji nga ky rrjet informacioni.

MENYRA E RAPORTIMIT

Nisur nga menyra e raportimit qe rrrethet dergojne ne I.S.H.P tabloja paraqitet si me poshte: Tab. 1



Pra themi qe ngjyrat alternohen me njera - tjetren dhe perqindja qe ze raportimi me e-mail (poste elektronike) shkon nga 30% dhe ne jave te veçanta deri ne 40%.


Raportimi me mjete te tjera (tel,fax. apo dorazi) ze pjesen tjeter te dergimit te te dhenave qe vijne ne Institut dhe rjedhimisht edhe perqindjen me te madhe ne menyren e raportimit.

Ne kete vit shikohet se kemi nje konsolidim te rretheve qe kane derguar qe nje


vit me perpara te dhena ne I.SHP me e-mail (Fieri, Shkodra etj.) si dhe gjithperfshirja e te gjitha rretheve ne dergimin e te dhenave me e-mail.

Fakti qe Saranda nga nje rrreth shume problematik tani eshte nje nga rrrethet me korakte ne kete drejtim e perforcon bindjen tone qe kemi se deri ne fund te ketij viti te arrijme nje perqindje raportimi me e-mail ne masen 80% - 90%.

Tab. 6 Ecuria e raportimit ne nivel rrrethi



SURVEJANCA ALERT E 20 JAVEVE TE PARA TE VITIT 2001



RAPORTIMI

Duke perjashtuar dy rrethe siç janë Permeti dhe Malesia e Madhe, te cilat nuk kane asnje formular te derguar ne I.S.H.P per kete periudhe, per rrethet e tjera rezulton e kunderta.

Pra kemi një perqindje te larte raportimi ne nivel rrethi, ndersa persa i perkthet komunave ne teresi raportimi varet shume nga disa faktore sic janë largesia nga qyteti, niveli i infrastrukturies, numri i mjekave ne qender shendetosore si dhe nga angazhimi i ketyre te fundit.

KOHA E RAPORTIMIT

Nje element shume i rendesishem ne kete sistem eshte koha e raportimit.

Eshte pranuar nga te gjithe ne qe nje formular te quhet ne kohe , ai duhet te jete ne I.S.H.P. brenda dites se merkure te javes pasardhese, duke pranuar veshtrise e ndryshme per komunikimin ne kohe, mendojme se koha ne dispozicion te rretheve per dergimin e formulareve eshte mese e mjaftueshme.

Pare ne kete sy rezulton se ka nje vonese te pajustifikushme ne dergimin e ketyre formulareve ne Institut.

Perqindja e dergimit ne kohe qe shkon nga 30% deri tek 59% megjithese eshte me larte se perqindja e atyre te ardhura me vonese (qe luhatet nga 27% deri tek 46%) perseri nuk eshte ne shifra te kenaqshme per ndjekjen ne dinamike te problematikes se ketij sistemi.

**Detaje mbi disa sindroma te marra ne analize per keto jave
Periudha e perfshire ne analize
01/01/2001-20/05/2001**

Sindroma "RASH ME TEMPERATURE"

Per 20 javet e analizes ka patur një raportim te konsiderueshem me 797 raste ne nivel vendi dhe incidence 23.9 per100 mijë. Per çdo grumbullim rastesh nga rrëthet eshte terhequr vemannja per te pare ne se percaktimi i rastit eshte bere mbeshtetur ne perkufizimin e rastit dhe nga ana tjeter per te vleresuar efektshmerine e fushates se vaksinimit ku per keto vite priten te kemi një numer me te ulet , se vite me pare ne nivel vendi.


Nga pamja grafike shohim se pikun me te larte te raportimit e kemi ne javen e 6 - te me 119 raste "rash me temperature" nga te cilat 32 raste i ka rapportuar rrëthi Mirdites dhe te gjitha rastet i takojne "URGJENCES" si njesi raportimi.

Po ne kete jave 43 raste i takojne Tiranes - fshat nga te cilat kemi 31 raste te rapportuara nga Kamza me një incidence

153.3 per10 000 banore.

Grupmoshat me te prekura ato jane te moshes pediatrike (0 -14 vjeç) me me shume se 75% te rasteve.

Nderkohe ne javen e 10 kemi 45 raste, por vlen te theksojme se perseri kemi një raportim te larte po nga Mirdita dhe nga njesia "Urgjence" me 16 raste qe besoj eshte një problem lidhur me perkufizimin e rastit. Vlen te theksohet se ne javet e fundit te perfshira ne raportim kemi një renie te rasteve dhe ne javen e 20 - te te raportimit kemi vetem 5 raste te rapportuara ne nivel vendi. (shih grafikun perkates).



"DIARE ME GJAK"

Per 20 jave jane rapportuar 69 raste ne nivel vendi dhe incidence 2.07 per 100 mijë ndersa javet qe kane numrin me te madh te rasteve jane ne javen e 4 - et dhe javen 7 - te (8 raste) , ne javet e

tjera ka nje raportime prej 3-4 rastesh.

Ne javen e 4 - et nga 8 raste gjithsej 7 raste i ka raportuar rrathi i Lezhes dhe nga komuna Zejmen me incidence 35.3 dhe 1 rast rrathi i Elbasanit , qytet.

Ne javen e 7 -te kemi po 8 raste nga te cilat 5 vijne nga Pogradeci me nje shperndarje : 3 nga ambulancat e qytetit dhe 2 nga "Urgjenca" me nje incidence 5.83 per 10 mijë si dhe 3 rastet e tjera te kesaj javë janë nga Tropoja qytet me nje incidence 8.58 per mijë.

Rastet jane te shperndara ne te gjitha grupmoshat.

Theksojme se njesia raportuese "URGJENCE" ze nje peshe te konsiderueshme ne shkalle vendi per te gjitha raportimet per sindromat, c'ka tregon se futja e kesaj njesie ne "alert" ishte e drejtë dhe me vlere (shih grafikun perkates).

"DIARE PA GJAK"

Rraportimi i rasteve per kete sindrome fillon me nje "shperthim epidemik" qe fillon qe ne javen e pare te janarit dhe arrin pikun e vet ne javen e trete me 1132 rastesh (shih grafikun me poshte) dhe pas kesaj javë kemi nje nivel qe mund ta konsiderojme si normal raportimesh per javet pasardhese.

Rastet me te shumta ne javen e trete raportohen nga rrethet kryesore te vendit si Tirana qytet dhe fshat, Korça, Vlore etj.


Nga ana jone kjo situate u ndoq me vemandje sidomos ne spitalin pediatrik te Q.S.U.T-se ku rezultoi se kishim te benim me nje situate epidemike virale me simptoma diareike kryesisht ne moshat pediatrike gje e cila beri qe te kemi nje ndryshim ne kurben klasike te diareve pa gjak.

Nga konfirmimi laboratorik kishim te benim me nje shperthim me natyre virale te shkaktuar nga rotaviruset, analiza te kryera ne I.S.H.P. dhe ne I.S.S-Rome, Itali

Kjo e ka prishur konfiguracionin karakterin stinor qe ka kjo nozologji me karakter stinor. (shih grafikun perkates).



Nr. i rasteve me diare pa gjak per 20 javet e para te vitit 2001




“VERDHEZA”

Ne numer absolut rastet per kete periudhe ne lidhje me verdhezen jane 212 ose me nje incidence 6.37 per 100 mijë ne shkalle vendi.

Megjithese per javet te veçanta (si java e 6, 8, 17, 20) kemi nje numer qe shkon deri 17-19 raste perseri mendojme se kemi te bejme me raste sporadike qe nuk perbene shqetesim per shendetin publik.

Nr.i rasteve me verdheze per 20 javet e para te vitit 2001




“INFEKSIONE RESPIRATORE TE POSHTME”

Raportimi per kete sindrome eshte ne shifrat 134269 ne numer absolut dhe (incidence 4038.1 per 100 mijë).

Ecuria e raportimit paraqitet me nje trend klasik te “infeksioneve respiratore te poshtme” qe pikun e vet e ka ne javen e 8 te ketij viti, pra ne fund te muajit shkurt dhe qe shkon deri ne fillimin e muajit mars.

Nr. i rasteva me infekzionete poshtme respiratore per 20 javet e para te vitit 2001



Eshte tashme e njohur qe ne kete periudhe te vitit vindi yne kaloi nje situate gripale pasojat e se ciles ishin te shoqeruar dhe me infeksione respiratore te poshtme e cila filloj nga pjesa bregdetare e vendit por qe ne te njejten kohe preku edhe Tiranen dhe duke u pasuar me vone ne pjesen tjeter te vendit.

Grupmoshat me te prekura rezultojne ato pediatrike me rreth 62% te totalit, dhe ne moshat pediatrike peshen kryesore e zene ato shkollorre.

Mbi disa probleme higjieno-sanitare të ujit të pijshëm gjatë vitit 2000

Dr. Valbona Bara Ing.Ekuel Jella

Per strukturat e profilaksise, kujdesi per mbrojtjen e ujit te pijshem, ne identifikimin e ndotesve ne mjedisin uje, eshte misioni dhe prioriteti kryesor udheheqes ne punen e ketyre strukturave.

Kjo lidhet me detyrimet tona per te menjanuar sa me teper efektet negative te ujit, ne kushtet e nje situate ku organet administrative te ujesellesave mbartin mangesi funksionale dhe riparuese per ujesellesat qe ata drejtojne .

Nder detyrimet me kryesore te Ndermarrjeve Ujesellese ne adrese te sigurimit te shendetit publik, mbeten furnizimi i panderprere me uje dhe mbajtja e presionit konstant te ujit ne rrjetin ujeselles, duke e siguruar ate ne cilesi dhe sasi te mjaftueshme ne sherbim te popullates .

Pothuajse ne te gjithe qytetet tona, furnizimi me uje te pijshem behet me nderprerje gjate 24 oreve, i kushtezuar nga fakti i sasise jo te mjaftueshme te ujit si dhe nga nderprerjet e energjise elektrike.

Keto faktore, duke iu shtuar edhe faktore te tjere jo pak te rendesishem si amortizimet e veprave dhe te rrjetit ujeselles, nderhyrjet pa kriter ne rrjet si dhe klorinimi jo korrekt i ujit, bejne te mundur qe shendetit publik te jete nen kercenimin e vazhdueshem te perhapjes se semundjeve infektive me rruge hidrike

Ne nivel distriktesh identifikimi i ndotesve ne mjedisin uje realizohet ne perçaktimin e ndotesve mikrobiologjik kryesist te indeksit MPN dhe te ndotesve me natyre kimike (kryesisht treguesit kimike te ndotjes).

Ndersa ne nivel kombetar dhe konkretisht ne ISHP realizohet identifikimi i nje game shume me te gjere ndotesish me natyre bakteriologjike, kimike dhe toksikologjike.

Duke u nisur nga sa u permend me siper, ne shume rrethe nuk behet identifikimi i ndotesve ne uje per arsyte objektive dhe subjektive dhe konkretisht :

Te mungeses se laboratoreve bakteriologjike dhe fiziko - kimike.

Mungeses se pajisjeve dhe reagenteve ne laboratore.

Mungeses se energjise elektrike .

Mungeses se personelit te kualifikuar.

Keto faktore per pasoje krijojnë per Inspektoriatin Sanitar Shteteror te ketyre rretheve veshtiresi ne njohjen e gjendjes higjieno-sanitare te ujit te pijshem per rrethin e tyre .

Ky fakt konkretizohet ne informacionet mujore qe DSHP-te e rretheve dergojne prane ISHP-se ne formen e formularit te unifikuar (fishes mujore) ku te dhenat e ekzaminimeve bakteriologjike mungojne plotesisht ose jane nje numer shume i kufizuar analizash , te cilave eshte vesh tire tu referohesh (1-5 analiza).

- Gjate vitit 2000 nuk jane kryer analiza bakteriologjike per mungesa ne laboratore ne qytetet: Delvine, Tropoje, Tepelene, Bulqize dhe Polican.

- ✓ Per mungesa te energjise elektrike nuk jane kryer analiza bakteriologjike ne Burrel - 5 muaj, ne Laç dhe Vlore - 3 muaj .
- ✓ Kryhen nje numer i vogel analizash bakteriologjike ne qytetet : Patos, Keliçyre, Has, Malesi e Madhe, Fushe - Arrez dhe Rubik.
Ne keto qytete mungojne laboratorret, por analizat i kryejne ne laboratoret e qyteteve me te afert.

Shume rrethe nuk kane derguar informacionet mujore per nje periudhe te gjate kohore gjate vitit dhe konkretisht : DSHP - te e rretheve Kruje, Bulqize, Tepelene Kavaje, Malesi e Madhe, Has .

Te gjitha mangesite qe u permenden me siper, krijojne veshtiresi te medha ne krijimin e nje informacioni unik , te sakte dhe te besueshem mbi cilesine e ujit te pijshem .

Prandaj mendojme qe me ngritjen e laboratoreve bakteriologjike dhe kimike dhe pajisjen e tyre me bazen e nevojshme materiale ne ato rrethe qe mungojne, do te kete nje fluks informative me te plotë , te sakte dhe te besueshem .

Duke u nisur nga informacionet mujore te ardhura ne Seksionin e Ujit gjate vitit, nga DSHP-te e rretheve, theksojme se ndotjet bakteriale me te medha te rrjetit ujesjelles ne qytete kane qene si me poshte :

- Ne Lezhe ne 75 % te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 62,5-87,5 %.

- Ne Burrel ne 35 % te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 61,1-100% (Siç eshte theksuar me lart per mungese te energjise elektrike per periudhen Gusht -Dhjetor 2000 , DSHP e Burrelit nuk ka kryer analiza bakteriologjike te ujit).
- Ne Berat ne 42 % te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 44-64%
- Ne Durres ne 83 % te periudhes kohore Janar-Dhjetor ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 11.1%-88.8%.
- Ne Ballsh ne 83 % te periudhes kohore Janar-Dhjetor ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 10-90%.
- Ne Lushjne ne 58.3% te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 40-80%.
- Ne Sarande ne 41.6 % te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 100 %.
- Ne Korçe ne 83.3% te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 6.6-40%.
- Ne Vlore ne 25% te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 46.6-69.2%.
- Ne Kuçove ne 33.3% te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujesjelles kane qene ne masen 9-63.6%

- Ne Laç ne 75% te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujeselles kane qene ne masen 12.5-87.5%.
- Ne Gjirokaster ne 83.3% te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujeselles kane qene ne masen 12.5-62.5%.
- Ne Kavaje ne 41.6 % te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujeselles kane qene ne masen 10-25%.
- Ne Puke ne 16.6% te periudhes kohore Janar-Dhjetor, ndotjet bakteriale te rrjetit ujeselles kane qene ne masen 100%.

Sic shikohet nga te dhenat e mesiperme ndotjet bakteriale te rrjetit ujeselles, kane qene te medha ne shume qytete te vendit dhe ne nje mase te madhe te rrjetit ujeselles.

Megjithate, gjate ketij viti nuk eshte konstatuar ndonje epidemi infektive me natyre hidrike, por vlen te theksohet se shperthime epidemike qe rrezikojne te marrin nje karakter me te gjere perhapjeje dhe ku mund te akuzohet uji ka patur sidomos ne qytetin e Shengjinit ne rrethin e Lezhës.

Ky fakt lidhet dhe me problemet qe paraqet ujesellesi i Lezhës, i cili sic e kemi permendur me siper paraqet ndotjet me te medha te rrjetit ujeselles gjate vitit

Ne keto kushte uji mbetet nje nga rreziqet me te medha potenciale per mundesine e shperthimit te epidemive infektive me origjine hidrike, pasi ekzistojne shume faktore favorizues:

1. Gjendja tejet e amortizuar e rrjetit

ujeselles dhe ne rastet kur rrjeti i ujesellesit punon me nderprerje (i kushtezuar nga mungesa te debitit te ujit dhe te nderprerjeve te zgjatura te energjise elektrike), atehere ujrat e perdorura mund te infiltrone ne tubacionet e ujit te pijshem , duke krijuar kushte te favorshme per ndotjen serioze te ujit te pijshem ,gjithashtu ne kushtet kur rrjeti i ujesellesit eshte i zbrazur ne tubacione krijohet vakum per shkak te te cilit ujrat qe ndodhen perreth depertojne ne brendesi te tij .

2. Nderhyrjet e shumta dhe pa kriter ne rrjetin ujeselles
3. Mungesa e klorifikimit te ujit dhe nivelet e uleta te klorit residual ne ujin e pijshem (ne shume ujesellesa klorinimi nuk eshte bere per muaj te tere ,shih tabelen per ditet pa klor ne ujesellesat e qyteteve).
4. Nje problem madhor qe nuk duhet lene ne hije eshte dhe problemi mbi mbrojtjen e zonave sanitare te burimeve ujore, mbrojtja e baseneve ujore nentokesore ,problem ky qe mendojme se ka ndikuar dhe ndikon drejtperdrejt ne cilesine e ujit te pijshem. Gjate ketij viti ne inspektimet tona qe kemi bere ne shume rrethe eshte konstatuar prishja e brezave te mbrojtjes sanitare te vendburimeve ujore, deri ne mosekzistencen e plote te tyre. Ne vend te tyre jane ndertuar shtepi banimi dhe ndertime te ndryshme , si dhe mbjellja e tokes ne afersi te

burimit ujor dhe perdonimi i kimikateve te ndryshme.

Ky perben nje rrezik potencial per te ardhmen pasi rrezikohen seriozisht te ndoten shtresat ujembajtese nentokesore te burimeve ujore, q'ka do te jetë shume e veshtire dhe e kushtueshme ne te ardhmen per korrigimin e cilesise se ujit. Keto mängesi jane verejtur ne Ujesellesat e qyteteve Vlore, Laç, Shkoder, Lezhe, Kavaje, Devoll, Tiranë, Burrel(Ujesellesi i Klosit, ujesellesi i Ulzes ku kaptazhi eshte i hapur dhe mundesia e kontaminimit eshte e larte). etj.

5.Duke shfrytezuar ujrat siperfaqesore te liqeneve dhe lumenjeve.

➤ Nje problem shume te rendessishem dhe shqetesues paraqesin problemet e ujit te pijshem ne fshat. Struktura e furnizimit me uje ne zonat rurale te vendit eshte e ndryshme. Ato furnizohen me uje te pijshem me ane te:

1. Ujesellesave rajonale
2. Ujesellesave lokale
- 3.Puseve individuale.
 - a. Puse te mbyllur me pompe dore.
 - b.Puse te hapur.

4 .Duke shfrytezuar burimet ujore natyrore.

Pothuajse ne te gjitha zonat rurale te vendit, ujesellesat nuk funksionojne rregullisht, shumica jane te shkaterruar totalisht disa te tjere nuk klorinohen .

Shumica prej tyre jane ndertuar ja-shte kushteve higjeno-sanitare.

Nje hallke te rendeshishme paraqesin problemet e administrimit te ujesellesave te fshatrave.

Lenia e tyre ne administrim te dyfishte (nga ndermarrja e ujesellesit dhe komuna e fshatit), ne shume raste kane ndikuar negativisht ne gjendjen higjeno-sanitare te tyre.

Ne disa rrethe ne zonat rurale te tyre nuk dihet gjendja sanitare e ujit te pijshem sepse nuk behet monitorimi (sido-mos i puseve vetjake qe jane hapur me shumice vitet e fundit).

Per kete qellim ne rekomojojmë te behet inventarizimi ne baze te modulareve tip sanitare dhe te ndiqet ne vazhdimesi me analiza kimike dhe baktereologjike cile-sia e ketyre ujrave.

Duhet t'i kushtohet vemendje klorinimit te pus-shpimeve vetjake ne baze te dozimit rekanduar ne rregulloret higjieno-sanitare.

Te gjitha anketimet qe do te behen nga ana DSHP i rretheve te dergohen prane sektionit te ujit prane Departamentit te Mjedisit dhe Shendetit ne ISHP, duke mundesuar keshtu krijimin e data-base e cila do te na ndihmoje ne hartimin e skemes se monitorimit analistik te ujrate te pijshem te zonave rurale te Shqiperise.

Shih tabelat ne faqen qe vijon:

Mbi disa probleme higjieno-sanitare të ujit të pijshëm gjatë vitit 2000

Dite pa klor qjate muajive ne ujesi eslesat e qyteteve qjate vitit 2000												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Ballish								5				
Berat								6	3	7		
Bilisht											3	
Burrel		1	1	1	11	4		9		31		1
Corovode	10	10	5	9	8	7	9	13	1	9	10	
Delvine		26	31	30	31	30	31	31	30		30	
Durres	6	2	12 pika		15 pika	11 pika	11 plka	2	2	3	5 pika	9 pika
Ereke					2 pika					1		17 pika
Fier	2	1										
Fushe-Arraz												
Has	2	3			8			10	11		2	
Gramsh	1	9	10	13	12	15		9	3	2	5	3
Gjirokaster	3		3		3 pika						4 pika	
Kelcyre												
Koplik	9		30	13		7						
Korce	3		5	2	2	4	1	6	4 plka	3	2	7
Kucove		3		4	1	3	3	5	2	14 pika	5 pika	
Kukesi												
Laci				1	1	1	1	3			1	
Lezhe		6	3 pika		14	31	30	31	12	6	5	30
Librazhd												
Lushnje												
Patos	30		30	1	5	12		4			30	
Peshkopi	2					1			4			
Polican												
Puke								4				
Rreshen			13			2	7	2	9	18	6	4
Sarande			31	31			31	31	3	7	10	10
Shkoder												
Tepelene					31	30	31	31				31
Ura-Vajgurore												31
Vlore					9	29						
Tirane	6 pika	2 pika			4	5 pika		2 pika	4 pika	7 pika		

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Ballish	10,0 %	10,0 %	20,0 %	30,0 %	30,0 %	50,0 %	90,0 %		80,0 %	60,0 %	40,0 %	
Berat	44,0 %						64,0 %	52,0 %	56,0 %	56,0 %		
Bilisht	28,5 %				12,5 %				37,8 %			
Bulgize						33,3 %						
Burrel	66,6 %	100,0 %	66,6 %				61,1 %					
Corovode	66,7 %											
Delvine												
Durres	66,7 %	88,8 %	41,1 %		57,9 %	57,9 %		72,2 %	22,2 %	16,6 %	11,1 %	55,5 %
Ereke					15,8 %	5,2 %			73,7 %	78,9 %	84,2 %	63,1 %
Fier												
Fushe-Arraz										100,0 %		
Has								90,9 %	18,1 %		9,0 %	
Gramsh										30,0 %		
Gjirokaster	12,5 %		62,5 %		37,5 %	62,5 %	62,5 %	50,0 %	37,5 %	50,0 %	37,5 %	50,0 %
Kavaje	10,0 %			12,5 %	25,0 %	12,5 %	12,5 %					
Kelcyre												
Koplik	66,7 %		33,3 %		33,3 %							
Korce	25,0 %		20,0 %	13,3 %	40,0 %	26,6 %	26,6 %	6,6 %	20,0 %	6,6 %	33,3 %	
Kucove	60,0 %								63,6 %	9,0 %	54,5 %	
Kukesi												
Laci	87,5 %	75,0 %	25,0 %	37,5 %	37,5 %	12,5 %	37,5 %	25,0 %	25,0 %			
Lezhe			62,5 %	62,5 %	87,5 %	62,5 %	62,5 %	87,5 %	87,5 %	62,5 %	62,5 %	
Librazhd									7,7 %	7,7 %		
Lushnje			55,5 %	55,5 %	60,0 %	60,0 %	50,0 %	80,0 %	40,0 %			
Patos									16,6 %	66,6 %	66,6 %	
Peqin								50,0 %				
Peshkopi			16,6 %						100,0 %			
Perrenjas										11,1 %		
Pogradec		6,6 %										
Polican												
Puke									100,0 %	100,0 %		
Rreshen			40,0 %					40,0 %	40,0 %	40,0 %		
Sarande			100,0 %	100,0 %		100,0 %	60,0 %		40,0 %	100,0 %	100,0 %	
Shkoder												
Tepelene												
Ura-Vajgurore										100,0 %		
Vlore	69,2 %		46,1 %	53,8 %								
Tirane		15,0 %						5,0 %				



Informacion mbi cilësinë e ajrit në Shqipëri

Agron Deliu, Dr.Qeramedin Kodra

Tabela dhe grafiku 1 jepin një krahasim te shkarkimeve kombetare ne ajer per vitet 1970, 1989 dhe 1998, te gjashte ndoteseve me te rendesishem te ajrit atmosferik: grimcave totale (LGS), bioksidit te sqafurit, oksideve te azotit, monoksidit te karbonit, hidrokarbureve dhe plumbit.

Viti	(Mije ton)		
	1970	1989	1998
Grimcat	81.5	349.2	145.4
SO ₂	177.1	462	236.5
NO _x	2.5	6.6	19.3
CO	1.2	3.3	31.7
HC	0.5	1.6	17.9
TOTAL	262.8	822.7	450.8

Burimi: Institut Studimeve te Ambjentit (ISA). Tirane 2000




Mund te shihet qarte qe ndersa shkarkimet totale jane zvogeluar ne masen 45 perqind gjate 10 vjeçarit te fundit 1989 - 98, si pasoje e renies drastike te aktivitetit industrial te vendit, jane rritur disa here shkarkimet specifikisht te lidhur me automjetet - monoksidi i karbonit, oksidet e azotit, hidrokarburet dhe plumbi.

Keta jane te perqendruar ne zonat me te zhvilluara urbane, dhe ndikojne mbi gati 1/3 e popullates se Shqiperise.

Shkarkimet e ketyre te fundit, qe konsiderohen ndotesa helmues, tanj perbejne rreth 15.2 perqind te ndoteseve total te ajrit ne Shqiperi ndaj 1.4 perqind ne vitin 1989. Ne qytetin e Tiranes ata perbejne rreth 65 perqind te ndoteseve te ajrit.

Tabela 2. Burimet stacionare dhe shkarkimet prej tyre

Viti	Shkarkimet totale nga lenda diegese ne burime stacionare, mije ton		
	1970	1989	1998
Grimcat	81.5	349.2	145.4
SO ₂	177.1	462	236.5
NO _x	2.5	6.6	19.3
CO	1.2	3.3	1.7
HC	0.5	1.6	0.9
TOTAL	262.8	822.7	387.8



Informacion mbi cilësinë e ajrit në Shqipëri

Tabela 3. Shkarkimet totale nga makinat, mijë ton

Viti	1989	1998	Te dhenat baze
Grimcat	0.6	12.5	1989 - 20 000 makina
SO ₂	0.4	8	1998 - 200 000 "
NOx	0.8	16	87% dizel, 13% benzine
CO	1.5	30	348 000 ton dizel/vit
HC	0.9	17	52 000 ton gasoil/vit
TOTAL	4.2	83.5	Shkarkimet e CO, HC dhe grimcave janë marre rrëth 50% me të lartë se teoriket. per efekt të moshës mesatare mbi 10 vjecare te makinave ne qarkullim.





Tabela 4. Rritja e numrit te automjeteve ne Shqiperi

Viti	1990	1992	1994	1996	1998	Tirana
Vetura	2000	15000	55000	60000	90000	27000
Kamiona	10000	11000	12000	22000	35000	8000
Autobuza	1000	2000	4000	5000	10000	2000
Te tjera	1000	5000	10000	10500	11000	2000
Total	14000	33000	81000	97500	146000	39000



Numri i mjetave te autotransportit ne Shqiperi (1990-98), dhe numri i tyre ne Tirane (1998) sipas llojeve kryesore.

2. Fenomeni i shiut acid ne Shqiperi

Per efekt te ndotjes se ajrit hasen perjithesish nivele te aciditetit te shirave qe variojne nga pH 4.6-5.6. Nivel me i larte i aciditetit te shiut eshte kapur ne Skoci (Pitlochrie) - pH 2.4.

Ekzistenza e shiut acid eshte identifikuar per here te pare ne vitin 1872 ne Manchester te Anglise, prej skocezit Robert Smith. Por pasojat e para te tij u kafen shume kohe me vone ne Skandinavi, aty nga fillimet e viteve 1970.

Shiu acid eshte problem rajonal, shkarkimet e oxhaqeve te larte te termocentraleve angleze e europiane kane ndotur ajrin mbi Skandinavi, psh. Keshtu ndodh edhe ne vendet e Europees qendrore e veriore.

Nga tabelat 5 dhe 6 shihet se Shqiperia ka nivele te parendeshishme shkarkimesh te gazeve acide, por bie ne sy sasia e madhe ndaj permasave te vendit tone e depozitimeve te squfurit. Kjo lidhet me permbajtjen shume te larte te S ne lendet djegese fosile tonat , qe kapercejne disa here (5-10) permbajtjen e tij ne lendet djegese fosile te vendeve te tjere.

Vendi	Depozitimi vjetor i squfurit (x 1000t)	Shkarkimet		PH	Prdhimi shllet energjise (million ton/ banore ekivalent naftës)	% energjise produhuar nga lende fosile per 10 banore	Nr. i veturave te Europees
		vjetore te NO ₂	vjetore te CO ₂ (t/banore)				
Shqiperia	118	7	2.8	5.4-3.3	1.6	0.3	
Belgjika	152	62	10.4	5.3	28.4	3.0	
Danimarka	78	45	9.9	4.5	96.6	3.1	
Francia	568	362	6.3	4.7	97.3	4.2	
Gjermania	1948	803	10.5	4.6	182.7	60.4	4.8
Irlanda	78	32	8.8	5.2	3.3	71.7	2.3
Hollanda	84	71	9.0	4.8	59.7	45.8	3.7
Norvegjia	18	94	9.0	4.4	120.2	1.0	3.8
Polonia	1362	822	9.6	4.3	97.3	98.3	1.4
Suedia	50	161	5.8	4.2	4.8		3.7

Per shkarkimet vjetore te NO₂ mund te thuhet se ato jane minimale, me qe shkaktohen kryesisht nga automjetet (e ne numrin mesatar te automjeteve per 10 banore Shqiperia eshte e fundit ne Europe) dhe jane thuaj se te pavarura ne pikepamje sasiore nga cilesia e djegies se karburanteve (gje qe s'mund te thuhet per CO₂ hidrokarburet dhe tymin-blozen e makinave).

Evitimi i shiut acid eshte jo i thjeshte. Desulfurimi i gazeve te pas djegies nuk eshte e vetmja zgjidhje. Nivelet e larte te permbajtjes se bioksidit te azotit dhe te hidrokarbureve te pa djegur ne gazet e automjeteve jane problem gjithashtu.

Tabela 5. Nivelet e shiut acid ne Europe

Vendi	Ton / ha depozita squfuri e azoti
Islanda, Irlanda, Norvegjia, Finlanda	0.0-0.5
Portugalia, Spanja, Franca, Suedia, Greqia	0.6-1.0
Italia, Shqiperia, Maqedonia, Rumania, Moldavia	1.1-1.5
Kroacia, Bosnja, Serbia, Bullgaria, Ukraina	1.6-2.0
Anglia	2.1-2.5
Belgjika, Hollanda	2.6-3.0
Gjermania, Polonia, ,ekia	mbi 3.0

3. Shqiperia si faktor ne ngrohjen globale te klimes

Klima e tokes ka ndryshuar gradualisht me stabilizimin e atmosferes rreth saj.

Faktori kontrollues eshte gjatesia gjeografike qe komandon intensitetin e rrezatimit diellor renes. Prej energjise dieollore qe vjen ne toke, rreth 30 perqind reflektohet prej tokes ne hapesire, 50 perqind absorbohet ne siperfaqen e tokes dhe pjesa tjeter absorbohet prej atmosferes.

Ardhja e energjise dieollore (100) b razohet me daljen e rrezatimit me vale te shkurtera (28) plus ate me vale te gjata (72). Keshtu sistemi mbahet ne ballance.

Nje fraksion prej 1 perqind i energjise dieollore ardhese fiksohet nepermjet fotosintezes per te formuar pemet dhe bimet, dhe kjo eshte sasia totale e energjise se fiksuar qe mban gjalle jeten mbi toke. Ndikimet kryesore te veprimtarise se njeziut mbi klimen globale jane:

1. Rritja e permajtjes se bioksidit te karbonit ne ajer.

2. Ndryshimi i albedos (reflektimit te drites) duke çpallezuar xhunglat, krijuar rezervuare uji dhe shtruar siperfaqe te medha me beton e asfalt.

3. Shkarkimet ne ajer te pluhurave e aerosoleve, qe mund te reflektojne rrezatimin diellor jonizues.

4. Vetite stratosferike mund te ndikohen prej fluturimeve supersonike ose prej pranise se klorofluorkarboneve (CFC-ve), qe demtojne shtresen e ozonit te atjeshem.

Disa gaze transmetojne rrezatimin me vale te shkurtera por nuk transmetojne

rrezatimin me vale te gjata.

Rreth 5 perqind e energjise reflektohet prej siperfaqes se tokes si rrezatim me vale te gjata. Disa lloje gazesh ne troposferen e siperme - sidomos bioksidi i karbonit, metani dhe klorofluorkarbonet (CFC-te)- e reflektojne perseri ne toke kete rrezatim me vale te gjata.

Qelqi ne nje serë e konservon nxehtesine sipas te njejtit parim, prandaj edhe keta lloj gazesh jane emertuar si "gaze te seres". Efekti i seres eshte shume i rendesishem; ne qofte se ai nuk do te ekzistonte fare, temperatura e planetit tone do te ishte 40°C me ulet dhe oqeanet do te ishin te ngrire. Por nje zmadhim i efektit te seres (i shkaktuar prej rritjes se permajtjes se gazeve sere ne atmosferë) mund te shkaktoje **ngrohjen globale**, qe shoqerohet me pasoja teper te renda.

Gjate shekullit te fundit permajtja e bioksidit te karbonit ne atmosferë eshte rritur nga 290 ppm ne 350 ppm, ose rreth 20 perqind (viti 1990). Me keto ritme rritje te CO₂ parashikohet qe ne vitin 2030 temperaturat ne zona te ndryshme te botes te rriten si me poshte: Europa jugore : 2°C ne dimer dhe $2-3^{\circ}\text{C}$ ne vere; Amerika e veriut : $2-4^{\circ}\text{C}$ ne dimer dhe $2-3^{\circ}\text{C}$ ne vere; Azia juge-lindore: $1-2^{\circ}\text{C}$ gjate gjithe vitit; Australia: $1-2^{\circ}\text{C}$ ne vere dhe 2°C ne dimer; Afrika nen Sahara: $1-3^{\circ}\text{C}$ gjate gjithe vitit.

Qysh tani eshte faktuar se dekada e viteve 1990 eshte me e nxehta e regjistruar mbi toke.

Ne vitin 1995 nje panel i OKB prej 2500 shkencetaresh pohoi qe aktiviteti i njeriut po prek ne menyre te rendesishme sistemet klimatike globale.

Bioksidi i karbonit eshte perjegjes per 55 perqind te efektit sere; CFC-te per 17 perqind; metani per 15 perqind dhe oksi-

det e azotit per 5 perqind.

Bioksidi i karbonit eshte perberes natyror i atmosferes.

Ai prodhohet gjate procesit te frymemarries se kafsheve e te bimeve. Por bioksidi i karbonit "naturor" formon vetem 0.03 perqind (rreth 300 ppm) te atmosferes. Perqendrimet me te larta te bioksidit te karbonit nuk jane aspak natyrore, ato shkaktohen prej njeriut

Ai formohet edhe kur digjen lendet e gjalla, keshtu qe eshte nje nen produkt i proceseve industriale qe perdorin lende dje-gese fosile (qymyr, gaz ose nafte) dhe i automjeteve qe djegin benzin ose diesel.

Djegia e 1 kg gazi natyror ciliron ne ajer rreth 1.8 kg CO₂ nderkohë qe djegia e 1 kg nafte ciliron 2.5 kg dhe ajo e 1 kg qymyri rreth 3 kg CO₂.


Ai prodhohet edhe gjate shperthimeve vullkanike dhe djegieve te pyjeve tropikale, me qellim perfitimi te tokave te reja te punueshme.

Menyra me e mire per te ndaluar keqesimin e gjendjes se efektit sere eshte pakesimi i shkarkimeve te bioksidit te karbonit prej industrise dhe automjeteve. 90% e CO₂ boteror formohet e shkarkohet ne ajer si rezultat i djegies se lendeve fosile.

Tabela 7. Shkarkimet boterore te bioksidit te karbonit (viti 1996):

SHBA	1.44	miliard ton	23%
ish BS	1	" "	16%
Kina	0.7	" "	11%
Japonia	0.3	" "	5%
Gjermania	0.28	" "	4.5%
Shqiperia	0.007	" "	< 0.1%
Vendet e tjera	2.47	" "	39.4%
Total boteror	6.25	miliard ton	100 %

Burimi: ISA, Tirane 2000



Po te shqyrtohen me kujdes shkarkimet globale te bioksidit te karbonit ne atmosferë nga aktiviteti i njeriut, (**tabela 7**) verehet se SHBA, ish BS dhe Kina shkarkojnë gjysmen e sasise boterore.

Nga ana tjeter sasia prej 6.25 miliard tonesh te shkarkuar ne vit kapercen te pakten per 2 miliard ton/vit aftesine absorbuese te CO₂ prej pyjeve dhe oqeaneve te planetit tone.

Keshtu, pritet shtim i vazhdueshem i permajtjes se CO₂ ne atmosferë. Qysh tani (viti 2000) SHBA shkarkojne 13% me shume se sa ne vitin 1990, ndersa Kina, Brazili dhe Indonezia 20-40% me shume.

Informacion mbi cilesinë e ajrit në Shqipëri

Tabela 8. Shkarkimet e bioksidit te karbonit ne Shqiperi nga djegia e lendeve

	1950	1960	1970	1980	1990	2000
Sasia/Viti						
Total CO ₂ , million ton/vit	0.07	1.02	3.42	9.68	9.74	7.7.2
Shkarkimi CO ₂ /banor, ton/vit	0.06	0.63	1.60	3.62	3.00	2.00

Burimi: ISA, Tirane 2000

Ajo kurse mjeti financiare dhe pakeson ndotjen e mjedisit, por shpenzimet kapitale filletare jane te larta.

Vendet e zhvilluara po korrin tani frutet e investimeve te meparshme per kerkime ne kete fusha. Veturat e tyre perdonin me pak benzine dhe shkarkojne me pak ndotesa te ajrit. Makinat e larjes se rroba ve konsumojne tani me pak uje te nxehte. Industrite e tyre te çelikut perdonin me pak qymyr. Shkarkimet e gazeve sere ne disa vende te zhvilluar (Gjermani, Hollande, Angli, etj) jane stabilizuar dhe ka filluar renia e tyre. Por ne European lindore dhe ish BS qeverite kane financuar çmimet e energjisise dhe industrite jo-eficiente deri pak kohe me pare.

Teknologjite me efikasitet energetik jane thuaj se te pa njo-hura ne ato vende; nivelet e ndotjes jane te larte dhe po vazhdojnë te rriten. **Grafiku 9** tregon se vendet e varfera kane nje shkarkim bioksidit karboni me te ulet per fryme se vendet me te pasura, dhe Shqiperia eshte e pa rendeshishme ne shkarkimet globale te CO₂ ne atmosferë (shih **tabelat 7 dhe 8**), por shkarkimi per dollar te PKB (Prodhimt Kombetar Bruto) eshte relativisht i larte.

Ketu perseri Shqiperia ka treguesit me te keqij - pra harxon shume lende djegese per nje njesi monetare te prodhuar (**grafiku 9**).

Burimi: 1) *Environment Today*, Dr. Trisha Greenhalgh, f. 101, London 1994; 2) *Statistical compendium for the Dobris Assessment*, f. 206-8, ECSC-EC-EAEC, Luxembourg 1995.

Nje nga rruget e pakesimit te gazeve sere eshte pa dyshim teknologja me efikasitet energetik, por ajo eshte mjaft e shtrenjte


4. Monitorimi i cilesise se ajrit per periudhen 1976 - 2000

a) Pluhuri qe depozitohet prej atmosferes mbi toke.

Ne **tabelen 10** dhe grafikun e meposhtem jepen te dhenat kryesore per pluhurin e depozituar ne disa qytete te Shqiperise. Verehet keqesim i gjendjes ne Tirane per periudhen 1977-98. Tejkalimi i normativeve vjetore te depozitimit verehet ne Tirane dhe ne Elbasan.

Tabela 10. Pluhuri i depozituar ne disa qytete te Shqiperise

	Viti 1977		Viti 1998	
	mg/m ² /dite	ton/km ² /vit	mg/m ² /dite	ton/km ² /vit
Tirana	249	91	380	139
Fieri	156	57	150	55
Elbasani	--	--	327	119
Korça	--	--	112	41
Norma e lejuar vjetore			200	73



Burimi:(1) Faktoret meteorologjike dhe problemet e ruajtjes se ambientit natyror, Izvi Daut-taj:Akademja e Shkencave e Shqiperise - Konferenca Shkencore per Problemet e ruajtjes se Ambientit Natyror, f.271-75, Tirane 1981.

(2) Raport per gjendjen e mjedisit 1997-1998, f.86, Agjensia Kombetare e Mjedisit, Tirane 1999.

b) Lenda e grimcuar ne suspension (LGS), bloza dhe bioksidi i squfurit

Qysh prej vitit 1976 e ne vazhdim ka patur monitorim te blozes e te SO₂ ne ajrin atmosferik te qyteteve tona, ku studimet baze jane perqendruar ne Tirane.

Ato Jane nndermarre fillimisht prej shrbimit te ndotjes se ajrit prane ish Institutit te Higjenes e te Epidemiologjise (ISHP sot), e vazhdohen po atje si dhe nga Instituti i Hidrometeorologjise.

Ne **tabelen 11** jepen rezultatet mesatare vjetore ne periudhen 1976-80 per LGS totale, blozen dhe SO₂ ne disa qytete te Shqiperise.

Nga **tabela 11** dhe **grafiku** duket menjehere se normat e lejuara sanitare tejkaloeshin ne Rubik dhe Laç per SO₂, me qe te dy kane qene qytete tipike industriale me shkarkime specifike te ketij gazi nga uzinat metalurgjike perkatese te shkrirjes se bakrit. Permbajtja e blozes ne ajer tejkalohej po ashtu ne Fier dhe Tirane, dy qytetet më industriale te vendit, ku qymyri zinte vendin kryesor si lende djegese per industrine dhe sektorin komunal:

Ketu ka vend te permendet fenomeni i njohur i shkaterrimit te pyllit ne malin e Gjallices, ne lindje te qytetit te Kukesit, si ne rast tipik i veprimit te demshem te SO₂.


Shkarkime kolosale te SO₂ ne ajer, te rendit 100 mijë ton/vit, kane vazhduar

Informacion mbi cilesinë e ajrit në Shqipëri

sistematikisht per rreth 30 vjet te demtojne pyjet dhe te mbjellat prane ish fabrikes se shkrirjes se bakrit te Gjegjanit-Kukes.

Perqendrimet e SO₂ te matur prej nesh ne periudhen 1974-80 ne ajer ne shpatin e malit te Gjallices, ne distance 2-4 km prej oxhakut te shkarkimit te fabrikes, arrinin normalisht vlera nga 1000-4000 µg/m³. Pas rreth 15 vitesh pylli u zhduk deri ne lartesine 1000 m te ketij mali dhe pas rreth 20 vitesh orteqet e pare te bores shkaktuan deme te medhenj njerezore dhe materjale ne fshatin Shtiqen dhe fshatrat e tjere te afert

Ne vitet '80 verehet renie e vazhdueshme e permajtjes se SO₂ ne ajrin e Tiranes. Ndersa permajtja e blozes dhe e grimcave me diameter me te vogel se 10 mikrometer ruan nivele pak a shume standarde, por gjithmone mbi normativat e lejuara sanitare (**grafiku 12**).



Grafiku 12 . Matjet e blozes e te bioksidit te squfurit ne Tirane, µg/m³, 1976-94.

Edhe raporti bloze / SO₂ ne qender te Tiranes vazhdimisht ka rezultuar ne shifra te larta, te nivelit 3 - 4. Po ti referohemi edhe grafikut 12 del me se e qarte teknikisht se permajtja jashtzakonisht e larte e blozes ne ajrin e Tiranes - edhe pse lenda djegese fosile e konsumuar per banor vazhdon te jete nder fare te ultat ne Europe (**tabela e grafiku 13**) - lidhet me nivelin e vazhdueshem teper te ulet teknik te paisjeve djegese kudo ne qytet. Per rreth dy dekada 1976-94 popullata i nenshtrohet masivisht veprimit te demshem te blozes se ajrit atmosferik, ne perqendrime 10-50 perqind me te larta se normativat sanitare te Shqiperise apo ato te KE.

Tabela 11 LGS totale,bloza dhe SO ₂ ne ajrin e disa qyteteve shqiptare,1976-80 (mikrogram/m ³)			
Qyteti	LGS	Bloze	SO ₂
Rubik		22	456
Laç		24	272
Durrës	186	15	46
Berat		16	14
Kuçova		22	48
Elbasan		31	51
Korçë		20	50
Fier		96	19
Vlore	212	35	43
Tiranë	268	67	30
Norma	500	50	150





Tabela 13 .Konsumi i lendeve djegese fosile ne Shqiperi, 1970-98,
(x 1000 ton ekuivalent nafte) dhe SO2 i qiluar prej tyre

Viti	1970	1980	1989	1998	
Qymyre	299	607	1307	541	Konsumi / banor ne Europe i lendeve
Gaz	106	322	879	185	djegese fosile ne vitin 1991 ka qene
Nafte	860	918	1114	964	si me poshte:
Total	1265	2847	3300	1690	Turqia - 0.9, Rumania - 2.6,
Konsumi	0.6	1.1	1.1	0.65	Greqia - 2.7, Gjermania-4.4,
					Rusia - 6.1,Luksemburgu - 9.3
/banor/vit (ton ekuivalent nafte)					
SO2 (mije ton/vit)	177	400	462	237	Shkarkimi / banor ne Europe i
SO2 (kg/banor/vit)	100	160	150	90	SO2 ne ajer ne vitin 1991 ka
					gene si me poshte:
					Turqia - 36, Rumania - 104,
					Greqia - 102, Gjermania - 176,
					Rusia - 244, Luksemburgu - 372,



Shumica e bioksidit te squfurit kriohet e shkarkohet ne ajer nga termocentralet e kaldajat qe djegin qymyr ose nafte, te cilat permbajne squfur. Tek ne ky prodhim eshte me pak se 0.3 milion ton/vit, me nje maksimum prej rreth 0.5 milion ton/vit ne fund te viteve '80, kur industria punonte me kapacitet te plote dhe kur eshte arritur edhe konsumi maksimal i lendeve

djegese e fosile ne shkalle kombetare prej 3.3 milion ton ekuivalenti nafe (viti 1989 - **tabela 13**).

Eshte me interes te jepen disa konsiderata e perfundime te hershme lidhur me efikasitetin e djegies te lendeve fosile, nisur nga studimi i permbajtjes ne ajrin atmosferik te LGS ne forme bloze e te SO2.

Teknikisht kur rapporti bloze / SO2 eshte me i madh se 1 ne ajrin atmosferik, kjo do te thote se djegia e lendeve fosile eshte jo efikase, duke rezultuar ne sasi te larta humbjesh ne forme karboni te pa djegur te flakur tej, nga burime stacionare ose te levizshem te djegies.

Ne periudhen 1976-80 ky report ne pikun referuese te qytetit te Tiranes ka qene 2.25, ne periudhen 1981-94 rezulton 3.88, dhe tani eshte vazhdimit ne vlera mbi 3.

Per krasim ne **tabelen 14** jepen disa vlera te te njejt report ne disa qytete te Europees.

Duhet theksuar se ky report teper i larte i Tiranes eshte perseri i ulur artificialisht nga fakti, se permbajtja e squfurit ne

lendet tona te djegshme eshte e rendit 3-5 here me te larte se ajo ne qytetet e krahasuar.


Del fare e qarte se tek ne kudo munagon plotesisht djegia efikase e lendeve fose, me pare (deri ne vitet 1990) kryesisht ne industri, sot kryesisht ne automjetet qe jane ndotesit kryesore te ajrit te qytezeve.

Tabeli 15. Resultatet e matjeve te PM 10 ne Tirane, $\mu\text{g}/\text{m}^3$, 1997-98.

1997/98	Spitalet	Gender	21 dhjetori
Janar	140	300	250
Shkurt	100	200	340
Mars	135	130	220
Prill	105	100	120
Maj	160	140	180
Qershor	130	105	170
Korrik	90	80	190
Gusht	90	91	150
Shtator	100	120	165
Tetor	95	140	190
Nendor	80	145	225
Mesatare	111	132	209
Norma OBSH	50		


Tabeli 14. Raporti bloze / SO₂ ne disa qytete te Europeve, periudha 1970-90

Qyteti	Raporti bloze / SO ₂	Lenda djegese e perdorur
Stokholm	0.33	Naftë
Paris	0.65	Naftë, qymyr, gaz
Milano	0.43	Naftë
Londer	0.27	Energi elektrike, gaz
Madrid	1.34	Naftë, qymyr
Bruksel	0.32	Naftë, qymyr, gaz
Tirane	2.25-3.88	Naftë, dru, qymyr



Ne vitin 1996 ne Tirane filloi nje menyre e re matjesh per lenden e grimcuar me dimensione grimcash nen 10 mikron (PM 10 - angl.).

Ne tabelen 15 me poshte jepen rezultatet mesatare mujore te permabjtjes se PM 10 ne ajrin e Tiranes per periudhen 1997-98.



Perqendrimet e grimcave me te vogla se 10 mikron (PM10) ne ajrin e Tiranes gjate vitit 1997-8.

Monitorimi i PM 10 ne ajrin e Tiranes eshte realizuar me ane te kater matjeve tre diteshe, te kryera ne intervale kohore 4-5 dite prej njera-tjetres.

Rezultati mujor eshte nxjerre duke bere mesataren e kater matjeve.

Rezultatet e matjeve te vitit 1997/98 tregojne qe niveli i grimcave nen 10 mikron, qe arrijne te depertojne ne mushkerite e njeriut, eshte i larte sidomos ne gender te qytetit dhe ne pikën e '21 dhjetorit', duke tejkaluar ne masen 100 - 200 perqind kufi-

rin e lejuar shendetesor, te vendosur nga OSH.

Ato me diameter me te vogel se 2.5 mikron quhen 'grimca te respirueshme' dhe mund te depertojne deri ne mushkerite e brendshme.

Shkarkimet e automjeteve me naftë (kamionet, mikrobuzet, veturat) janë perqjeqjes per shumicen e PM10 ne ajer, ku pjesa e tyre ne sasine e blozes se per gjithshme varion nga 80-90 perqind te sasive totale te PM10, te hasur ne ajrin urban.

Keto shkarkime mund te jene kancerogjene.

c) Ndotesit helmues te shkaktuar nga trafiku
Automjetet dizel zene rreth 85-87 perqindte numrit te per gjithshem te automjeteve ne Shqiperi (viti 1998).

Kjo lidhet me faktin e varferise se popullates dhe çmimit me te lire te karburantit perkates se benzina. Por karburanti dizel ka mjaft veçori, qe perbejne ngarkesa serioze mjedisore.

Karakteristika kryesore e shkarkimeve te dizelit, eshte formimi e cilrimi i grimcave ne sasi 20 here me te medha se sa tek makinat e benzines.

Keto grimca perbehesh prej C elementar, komponimesh organike te adsorbuar prej karburantit dizel dhe vajrave lubrifikuese te motorrit, sulfateve te formuar nga squfuri i karburantit dhe gjurma komponimesh metalike.

Shumica e lendet se grimcuar totale i takon diapazonit nen 1 mikron te grim-

cave (midis 0.02 dhe 0.5 mikron) por diametri maksimal mund te arrije deri 30 mikron.

Komponimet organike zakonisht per bejne 10-30% te lendet se grimcuar totale, por ne motorret e vjetër - deri 90%.

Ky eshte e dhe rasti tipik i Shqiperise ku shumica e makinave dizel kane motorre mjaft te vjetër.

Ne tabelen e me poshteme shifrat per Shqiperine janë krejt te lidhura me vjetertine e motorreve dhe mungesen e pote ose thuaj se te pote te konvertoreve katalitike ne makinat qe qarkullojne brenda saj.

Tabela 16.

Perberja e shkarkimeve te dizelit te veturave

Komponenti	Perqendrimi (% ne peshe)	
CO ₂	7.1	
Avuj H ₂ O	2.6	
O ₂	15.0	
N ₂	75.2	
CO	0.03	
HC	0.0007	
NO _x	0.03	fakti ne Shqiperi 0.1 - 12
H ₂	0.002	fakti ne Shqiperi 0.05 - 0.2
SO ₂	0.01	
Sulfate	0.00016	
Aldehide	0.0014	
NH ₃	0.00005	
Grimca	0.006	fakti ne Shqiperi 0.08 - 6

Sipas Volkswagen AG (1989)

Vjetorimi i motorrit jep rritje te shkarkimeve te hidrokarbureve, lendet se grimcuar dhe hidrokarbureve policiklike aromatike (HPA).

Veçanerisht rriten shkarkimet e CO e te lendet se grimcuar, krahasuar me hidrokarburet e oksidet e azotit.

Faktoret mesatare te perkeqesimit te shkarkimeve çdo 2500 km rruge (pune), janë: monoksidi i karbonit 0.97; oksidet e azotit 0.96; hidrokarburet 0.91; lenda e grimcuar 1.07; fluorantene 0.96; pireni 1.06; kriseni 0.62; benzo(a)pireni 0.68; etj.

Informacion mbi cilesinë e ajrit në Shqipëri

Matje te blozes ne ajrin e qendres se Tiranes dhe prane qendres se qytetit te Fierit jepin rezultatet e me poshtem per periudhen 1976-2000 (**tabela 17**).

Rritja e blozes ne ajer lidhet direkt me shkarkimet e makinave me motorre dizel.

Duke filluar nga viti 1996 ne Tirane filloi matja e ozonit (O_3) nga ana e sherbimit perkates ne ISHP (ish IHE), me stacionin automatik. Ne piken e references prane ISHP ozoni matej ne menyre te vazhdueshme

Ndersa ne gjashte pika te shperndara ne qytet matet me kapesa pasive bashke me bioksidin e azotit (NO_2).

Ne **tabelen dhe grafikun 18** me poshte jepen rezultatet mesatare mujore te ozonit e te bioksidit te azotit per periudhen 1997-98.

Tabela 17. Permbajtjet e blozes ne ajer ne qendren e Tiranes dhe Fierit, $\mu\text{g}/\text{m}^3$			
Qyteti / viti	1976-80	1981-90	1981-94
2000			
Tirana, gender	67	72	253
Fieri, gender	96	101	135
Norma			50






Tabela 18. Rezultatet e matjeve te ozonit e te bioksidit te azotit ne Tirane, 1997-98.

	O_3		NO_2	
	ISHP	Qender	ISHP	Qender
Prill	60			36
Maj	52	62	3	37
Qershor	51	84	6	43
Korrik	45	70	5	37
Gusht	46	63	15	30
Shtator	47	100	7	33
Tetor	53	58	6	39
Nendor	40	60	23	34
Mesatare	49	71	9	36
Norma OSH		100		150

Grafiku 18

Perqendrimet e ozonit ne Tirane gjate vitit 1997/98.





Per O₃ dhe NO₂ perqitethesish matjet jepin akoma vlera larg niveleve te rrezykut per populaten ne Tirane.

Perqendrimet e O₃ dhe NO₂ ne bresidi te qytetit shihet se jane disa here me te larta se ne periferine ku ndodhet ISHP.

Kjo shpjegohet me shkarkimin e gaseve te djegies nga makinat ne qarkullim.


Vlerat me te larta hasen prane arteieve kryesore, si tek qendra e qytetit. Por Tirana eshte rrith dy here me e ndotur se qytetet e tjere (**tabela 20**).

Matje analoge me metoda pasive te marrjes se mostrave ne qytetet e Durrësit, Vlora e Shkodres kane dhene rezultatat e me poshtem, per periudhen shkurt-korrik 1998:

Tabela 20. Ozoni dhe bioksidi i azotit ne ajrin e disa qyteteve ne Shqiperi		
	Ozoni, µg/m ³	Bioksidi i azotit, µg/m ³
Durrës	51	10
Vlora	43	12
Shkodër	11	17
Tirana	71	36
Norma e OSH	100	150


Duke filluar nga muaji tetor 2000 po ndiqet rregullisht me metoda aktive permbajtja e LGS, blozes, PM 10, SO₂ dhe NO₂ ne ajrin e qyteteve Tirane, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Vlore. Permbajtja e O₃ analizohet me metode pasive, si edhe më pare. Rezultatet kryesore te fases tetor-dhjetor 2000 jepen grafikisht me poshte, ne grafikun 21, ku per reference jepen edhe vlerat e rekomanduara nga OSH.

Grafiku 21. Permbledhje e rezultateve te matjeve per periudhen tetor - dhjetor 2000, per permbajtjen e LGS, PM 10, blozes, SO₂, NO₂ dhe O₃ ne ajrin e qyteteve kryesore te vendit.



Sic shihet prej tabelave dhe grafikeve te mesiperm ajri i Tiranes dhe i disa qyteteve tetjere (Fieri, Elbasani, Durrës, Vlora) permban vlera te larta te blozes, PM 10 e te LGS ne ajer, te lidhura me shtimin e numrit te automjeteve ne vendin tone gjate dekades sefundit.

Veçanerisht problematike eshte Tirana ku hasen tejkalime disa hereshe te permbajtjes se blozes e te PM10 ne ajrin urbân, referuar normave tona dhe rekomandimeve te OSH. Tirana eshte nje nder pikat me te nx-



hta te Europe ne pikepamje te ndotjes se ajrit urban. Permbajtjet ne te te LGS dhe te blozes jane ne shkalle absolute me te lartat ne Europe (****): LGS - Tirana 1 = 467 µg/m³, Tirana 2 = 343 µg/m³, Tirana 3 = 108 µg/m³ Donetsk (Ukraine) = 415 µg/m³, Krivoi Rog (Ukraine) = 365 µg/m³, Krasnodar (Rusi) = 300 µg/m³, Torino = 155 µg/m³, Moske = 100 µg/m³, Prage = 84 m³, Hamburg = 54 µg/m³, etj.

Bloze - Tirana 1 = 280 µg/m³, Tirana 2 = 221 µg/m³, Tirana 3 = 46 µg/m³, Santa Cruz De Tenerife (Spanje) = 113 µg/m³, Athine = 58 µg/m³, Varshave = 53 µg/m³, Londer = 23 µg/m³, Lubjane = 23 µg/m³, etj.


**** Exposure of urban population in the WHO European Region to major air pollutants, EUR/TRNS 020102, Bilthoven 1997.

Shenim: Tirana 1 - qendra e qytetit, lartesia e matjes 5m,

Tirana 2 - qendra e qytetit, lartesia e matjes 15m,

Tirana 3 - ISHP, ne distance 3 km ne lindje te qendres se qytetit, lartesia e matjes 15

Fig.22. Permbajtja e LGS dhe blozes ne ajrin e disa qyteteve



Perfundime

- Pas ndrrimit te sistemit ekonomik ne Shqiperi ne fillim te viteve '90 verehet ulje sasiore e shkarkimeve te demshme ne ajer nga industria dhe rritje rrreth 20 hereshe e shkarkimeve te demshem nga automjetet.
 - Zona Tirane - Durres po i nenshtrohet ndotjes masive te ajrit nga ana e shkarkimeve te pa kontrolluar nga automjetet. Kjo zone ka tani rrreth 1/3 e popullates se vendit dhe 1/2 e numrit te automjeteve.
 - Ndotesit kryesore te ajrit aktualisht jane LGS, bloza, PM 10, monoksidi i karbonit, hidrokarburet policiklike aromatike (HPA) dhe ndotesit fotokimike (ozoni e bioksidi i azotit), te lidhur thuaj se teresisht me shkarkimet e trafikut ne Shqiperi. Ne disa qytete te Shqiperise LGS, bloza dhe PM 10 jane disa here mbi normat e lejuara te vendit e te OSH.
 - Mungon thuajse teresisht ndergjegjesimi e veprimi efikas i organizmave perjegjes (vendim marres e ekzekutive) per perballimin e problemit te ndotjes se ajrit, qe po behet fenomen i rrezikshem shendetosor per nje pjese te konsiderueshme te popullates urbane te vendit.
- Burimi: 1) Exposure of urban population in the WHO European Region to major airpollutants, EUR/ TRNS 020102, Bilthoven 1997; 2) Monitorimi i cilesise se ajrit ne Shqiperi per vitin 2000, ISHP - Seksioni i Ajrit. (Konkluzionet vijojne ne fq 43)*

Epidemia e gripit ne Shqiperi ne vitin 2001, shkaktari dhe perhapja e tij.

Dr. Bujar Brahimaj, Mikrobiologe Alma Robo

Gripi eshte nje semundje infektive qe manifestohet ende sot ne formen e nje epidemie te vogel lokale e sporadike, ne formen e nje epidemie kombetare ose rajonale, apo edhe te nje pandemie boterore qe prek ne nje kohe relativisht te shkurter rrreth 30% te popullates se nje vendi. Si i tille gripi c'orienton jeten socialo-ekonomike te vendit dhe ve ne nje gjendje alarmi sistemin kombetar shendetesor.

Graviteti dhe shtrirjet e ndryshme gjeografike te epidemive jane te lidhura me tre tipet e ndryshme te virusit te gripit te emertuara A, B dhe C. Fuqia patogene dhe infektive per secilin tip percaktohet nga proteinat qe ato mbajne ne siperfaqen e tyre: Hemagglutinin dhe Neuraminidazen.

Keto proteina jane antigene, d.m.th. shkaktare te formimit te antikorpeve specifike ne organizmin e infektuar. Perberja ose struktura e ketyre antigeneve modifikohet papushim nga ku lindin viruse variante (variacione antigenike) qe ndryshojne ne karakteristikat e tyre nga viruset e meparshtme.

Kjo i dedikohet aftesise qe kane viruset e gripit per te pesuar ndryshime te vazhdueshme progresive te struktureve antigenike siperfaquesore, pra te Hemagglutinines dhe Neuraminidazes, qe cojne ne shfaqjen e nentipeve ose varianeve te reja dhe si pasoje ne perhapjen epidemike te semundjes.

Keto modifikime antigenike jane me te theksuara dhe me te studiuara te virusi i gripit tip A.

Ne vitin 1968 ne Honkong u izolua nje nentip i ri i ketij virusi dhe ne dallim

nga nentipat e meparshem A/H1N1, A/H2N2, u emertua si virus i nentipit A/H3N2.

Vitet qe pasuan treguan se shfaqja e nje nentipi te ri nuk zhduk nga qarkullimi variantet e reja te nentipeve te meparshtme.

Keshtu ne vendet e ndryshme te Europes dhe botes u vune re perseri epidemi apo qarkullim te virusit te gripit A/H1N1 krahas atij te nentipit A/H3N2.

Ne vendin tone virusi i nentipit A/H1N1 qarkulloi ne menyre sporadike gjate sezonit 1978-1979, por shkaktari kryesor i epidemise ne ate periudhe ishte B/Hanover/3/75.

Ne kete, material pershkruhet shkaktari i epidemise se gripit ne vendin tone dhe rezultatet e ekzaminimeve laboratorike ne periudhen Dhjetor 2000 - Shkurt 2001

Materiali dhe metoda.

Per gjendjen imunitare te popullates ndaj viruseve te gripit u ekzaminuan me ane te reaksioneve te hemagglutinacionit-inhibicionit 113 serume per muajin Dhjetor 2000 dhe 98 serume per muajin Janar 2001. Serumet u moren ne spitalin pediatric te Tiranes si dhe ne subjekte te shendoshe te qyteteve Tirane, Kruje. Keto ekzaminime u kryen me kite te references te ardhura nga Qendra Nderkombetare e Gripit ne Londer.

Per izolimin e virusit te gripit u moren ne daten 08.02.01, 10 tampona sekrecionesh nazo-faringeale ne Tirane dhe me daten 16.02.2001, 16 analiza te tjera

ne Kukes , ne personat e semure ne 1-3 ditet e para te shfaqes se semundjes dhe me shenjat me kryesore te gripit: temperature 39-40 grade, dhimbje koke, gjendje debulese dhe dobesi fizike, dhimbje e muskujve dhe kyceve, skuqje dhe lotim te syve, dobesim te pulsit, humbje te oreksit, vjellje etj.

Sekrecionet nazo-faringeale te marrë me tampon u vendosen menjehere ne epruveta me 2ml solucion Hanks, me 10% xhelatine, 1000ui/ml peniciline, 250gama/ml streptomicine dhe bikarbonat natriumi ne sasine e nevojshme per ta cuar solucionin e punes ne ph

7.6.

Materialet (analizat) u derguan menjehere ne laborator ne termus me akull dhe u futen ne frigorifer ne temperaturen -70°C deri ne momentin e inokulimit.

Keto materiale u inokuluan ne sakusin amniotic dhe allantoik te embrioneve 10 diteshe te vezeve te pules. Embrionet e inokuluara u lane tre dite ne termostat ne 35 °C dhe nje nate ne 4 °C.

Likideve amniotike dhe allantoike te embrioneve te inokuluara iu be prova e reaksionit te hemaglutinacionit per prani virusesh. Identifikimi i virusave te izoluara u krye me ane te reaksionit te pengimit te hemaglutinacionit (RHI) duke futur ne reaksion izolatet tona virusale krahas

antigeneve te references me antiserumet standarte te references per viruset e gripit

Rezultatet dhe diskutimi

Ekzaminimet serologjike (serogramma mujore) e muajit Dhjetor 2000 dhe e Janarit 2001 tregoi nje rritje ne dinamike te titrave hemaglutinues, te titrave mesatare gjeometrike (TMGJ) dhe te peshes specifike te raportit te titrave te mesem dhe te larte ndaj titrave te ulet (P_2+P_3/P_1) kryesisht per nentipin A/H1N1 dhe me pak per nentipin B (shih tabelen Nr. 1).

Tabela Nr. 1. Rezultatet e serogrames per muajin Dhjetor 2000-Janar 2001.

Muaji	Grup-mosha	Shtami	Titri ≥1:128	Titri ≥1:256	Titri mbrojtës ≥1:64(%)	TMGJ	P_2+P_3/P_1	Nr. i serumeve
Dhjetor 2000	0-6 vjec	H1N1	24	1	12	15	0.47	25
		B	25	0	0	6	0.19	25
	7-14 vjec	H1N1	23	2	28	25	0.56	25
		B	25	0	4	9	0.76	25
	15-29 vjec	H1N1	25	1	15	18	0.44	26
		B	26	0	11	9	0.44	26
	> 30 vjec	H1N1	37	0	4	8	0.09	24
		B	25	0	50	21	3	12
	Total	H1N1	109	4	14	14	0.32	113
		B	101	0	14	10	0.66	101
Janar 2001	0-6 vjec	H1N1	7	18	92	235	11.5	25
		B	25	0	32	12	0.56	25
	7-14 vjec	H1N1	14	9	65	76	2.8	23
		B	22	1	82	51	6.6	23
	15-29 vjec	H1N1	18	8	50	46	1.36	26
		B	20	6	88	65	12	26
	> 30 vjec	H1N1	21	3	29	19	0.6	24
		B	15	9	79	101	5	24
	Total	H1N1	60	38	59	63	1.88	98
		B	82	16	70	44	2.92	98

Keshtu virusi i gripit i nentipit A/H1N1 i perfaquesuar ne serograme me A/

Beijing/262/95 (A/H1N1) per muajin Dhjetor eshte gjetur ne titra te larte (1:256) ne 4 raste ose e shprehur ne perqindje 3.5%, me TMGJ 1:14 dhe me peshe specifike 0.32. Per muajin Janar 2001 keto parametra ndaj ketij nentipi rriten dukshem dhe konkretisht:

- titrat e larte hemaglutinues i gjejme ne 38 raste (39%)
- TMGJ 1:63
- raporti i peshes specifike te titrave te larte e te mesem ndaj atij te ulet eshte 1.88

Persa i perket grup-moshave rezultatet tregojne se numrin me te madh te rasteve me titra te larte e gjejme ne grup-moshat 0-14 vjec (27 raste nga 38 gjithsej).

Virusi i gripit i nentipit B i perfaqesuar ne serograme me B/Beijing/ 243/97 eshte gjendur ne titra te larte vetem per muajin Janar 2001 ne 16 raste, titra qe i hasim kryesisht ne moshat e rritura mbi 14 vjec.

Kjo tregon se ky virus qarkullon ne menyre sporadike ne popullaten e vendit tone.

Po keshetu analizat mujore per muajin Dhjetor 2000 tregojne ne perqithesi per nje nivel mbrojtës 1:64 te ulet (14%), e cila vjen si rezultat i mosqarkullimit per nje kohe te gjate i ketyre shtameve sidomos ai i nentipit A/H1N1 qe nuk ka qene i pranishem ne popullaten e vendit tone qe prej vitit 1979.

Mungesa e qarkullimit per nje kohe te gjate e nje nentipi, si dhe ndryshimet e vogla (minore), siperfaquesore, qe ka pesuar nentipi aktual A/H1N1 bejne qe popullata e nje vendi sidomos ajo feminore dhe e moshes se re te mos kete njohje imunologjike ndaj variantit te ri qe shfaqet dhe qe qarkullon ne popullate.

Kjo pervoje tregoi me se miri se ne muajt pasardhes (Janar, Shkurt, Mars) vendi yne u perfshi nga nje epidemi gripi dhe shkaktari i saj, sic u vertetua dhe nga analizat virologjike ishte virusi i gripit A/H1N1.

Analizat serologjike tregojne gjithash tu se incidenca e gripit ka ndodhur ne te gjitha moshat por me e larte eshte ne moshat feminore dhe ato te reja; ndersa me e ulet ne moshat e rritura.

Kjo dukuri, pra e incidences me te ulet ne moshat e rritura i dedikohet pjesshri kontakteve te perseritura qe individet e moshave te avancuara kane patur me variantet antigenike te meparshme, gje qe u siguron atyre nje mbrojtje te pjesshme.

Duke u nisur nga te dhenat serologjike, epidemiologjike dhe nga sinjalizimet e poliklinikave apo institucioneve te ndryshme shendetesore, laboratori i gripit kreu dhe analiza te tjera virologjike.

Analizat virologjike (izolim virusi) qe u kryen per 10 te semure me klinike gripe ne rrithin e Tiranes dhe 16 persona te semure me grip ne rrithin e Kukesit vertetuan plotesisht te dhenat e rezultateve te analizave serologjike.

Nga 26 analizat e marra ne personat e semure me grip u izolua virusi i gripit ne 10 persona. (Shih tabelen Nr.2) ne titrat 1:4-1:1024, por vetem tre prej tyre dhe konkretisht izolatet nr.8 ,10 dhe 13 dhane titra te larte hemaglutinues 1:256 -1:1024 ne pasazhin e dyte dhe te trete, titra te cilat lejojne mundesine e identifikimit te virusit te gripit, (materialeve te Kukesit iu bene vetem dy pasazhe per mungese te embrioneve te vezeve te pules).

Epidemja e gripit ne Shqiperi ne vitin 2001, shkaktari dhe perhapja e tij.

Tabela Nr. 2 Rezultatet e hemaglutinacionit te shtameve te izoluara

Nr. i shtamit	Pasazhi I	Pasazhi I	Pasazhi II	Pasazhi II	Pasazhi III	Pasazhi III
	Likidi Allantoik	Likidi amniotik	L. Allantoik	L. Amniotik	L. allantoik	L. Amniotik
1	1:2	1:64	-	-	-	-
3	-	1:64	1:4	-	-	-
4	-	1:4	-	-	-	-
5	-	-	1:2	1:4	-	-
7	-	-	-	1:4	-	-
8	1:8	1:2	1:512	1:32	1:1024	-
10	1:256	1:2	1:256	-	1:1024	-
13	1:16	-	1:1024	-	-	-
16	-	1:2	1:4	-	-	-
18	1:32	-	1:8	-	-	-

(H1N1), ndersa me antiserumet A/Sydney /5/97(H3N2) dhe B/ Beijing/243/97 jepin reaksiuni RHAI negativ ose pengim te reaksiunit me antiserumin B/ Beijing/243/97 ne titrin 1:40 (shtami nr. 13) qe konsiderohet negativ. Po ne kete tabele shihen titrat e

Shenim: Kuadratet pa shenja tregojne per mospasazhim te shtamit.

Tre shtameve qe rezultuan me titra hemaglutinues te larte iu be reaksiuni i hemaglutinacion - inhibicionit per tipizimin e tyre.Kete procedure e realizuam duke futur ne reaksiuni isolatet tona krahas antigeneve virusale te references.

Te dhenat e ketyre ekzaminimeve po i japim ne tabelen nr. 3

Tabela Nr.3 Rezultatet e reaksiunit RHAI per tipizimin e virusave te gripit te izoluara gjate vitit 2001.

shtameve te references me serumet tipospecifike (serum test) dhe nga krahasimi i tyre rezulton qe te tre isolatet nga pikepamja antigenike jane te peraferta (jo te ngjashme) me A/Beijing/262/95 pra me diferenca te vetyve antigenike ndaj A/Beijing /262/95 sepse ne proven e HI te tre isolatet ne reaksiuni me serumet e references anti A/Beijing/ 262/95 kishin ndryshim titrash ne masen mbi 4 here e me shume ne krahasim me serumet dhe shtamet e references. Te 4 shtamet e izoluara (shtami nr.8,10,13 dhe shtami nr.18 me titer te ulet) u derguan ne Qendren Nderkombetare te Gripit ne Londer per konfirmim dhe studim te metejshem te tyre.

Ne tabelen nr.4 paraqiten te dhenat e kesaj qendre per tre shtamet e virusit te gripit te izoluuar ne Shqiperi, nederkohe qe shtami nr.18 nuk pati rritje te titrit edhe ne Qendren Nderkombetare te Gripit ne Londer dhe si i tille ai nuk mund te identifikohej.

Sic shihet nga tabela isolatet nr.8, 10 dhe 13 jepin nje reaksiuni hemaglutinacion-inhibicion (RHAI), pozitiv ne hollimin 1:1280 me serumin tipospecific A/Beijing/262/95

Tabela Nr.4. Titration - Inhibition Test:H1N1

Viruses	Isolation Date	Post infection ferret sera					
		A/ Bay/7/95	A/JHB 82/96	A/Beijing/26 2/96	A/NC 20/97	A/H-K 1252/00	A/Mad 57794/00
A/Bayern/7/95	25/01	5120	80	40	<	80	
A/Johannesburg 8/96	25/01	5120	80	40	<	80	
A/Beijing/262/96	40	80	640	320	80	320	
A/New Caledonia 20/99	40	80	160	640	160	640	
A/Hong-kong 1252/00	<	<	<	80	640	80	
A/Madagascar 57794/00	40	40	160	640	160	640	
A/Albania 8/01	8.02.01	<	40	160	640	40	640
A/Albania 10/01	12.02.01	<	40	80	320	40	320
A/Albania 13/01	16.02.01	<	40	80	320	40	320

Ne kete tabelle paraqiten titrat e shtameve te references me serumet tipospecifik(serume test) dhe duke i krahasuar ato me tre izolatet tona rezulton se keto te fundit jane nga pikepamja antigenike te ngjashme me dy shtamet e references, A / New Caledonia / 99 dhe A / Madagaskal / 57794/000 qe i perkasin virusit te gripit A / H1N1 por qe ka nje shmangje antigenike me A/Beijing/262/96(dr. Alan I.Hay. Division of Virology.National Institute for Medical Research London NW71AAUK).

Sipas raporteve te OBSH gjate ketij sezonit ka predominuar shtami i gripit i nentipit A/H1N1:Epidemi apo shperthime te lokalizuara kane ndodhur ne Finlande, Federaten Ruse, Angli, Jugosllavi, Greqi, Gjermani, Zvicer ShBA. Pjesa me e madhe e ketyre viruseve kishin lidhje te ngushta antigenike analog me A/New Caledonia / 20/99 dhe A/Madagaskal/57794/00.

Ekzaminimet virologjike, serologjike dhe seroepidemiologjike jane elemente kryesore per percaktimin e strukturares antigenike te shtameve qarkulluese te viruseve te gripit, per zhvillimin e niveleve te ndjeshmerise dhe te pjesemarrjes ne proceset epidemike te grup-moshave te ndryshme.

Keto ekzaminime lejojne te vihet ne dukje qarkullimi i viruseve te gripit i nentipeve A/H3N2 , A/H1N1 dhe B me intensitet te vashdueshem dhe alternativ e cila justifikon perdorimin e vaksino-profilaksise me

preparate polivalente qe permajne anti-gene gripale A dhe B te rekomanduara nga OBSH i cili bazohet nga te dhenat dhe rezultatet e laboratoreve kombetare.

Prandaj duhet dhe eshte e domosdoshme qe laboratori i gripit te ndjeke ne cdo kohe dhe vazhdimeshit situaten para epidemise, gjate dhe mbas saj.

Keshtu ky laborator do te kontribuojte jo vetem parashikimet e mundshme te nje epidemie, por do te jape ndihmesen e vete edhe qendrave nderkombetare me shtamet e gripit qe izolon ne vend ky laborator.

PERFUNDIME

- Analizat serologjike te kryera me RHA treguan per nje rritje te ndjeshme te titrave te antikorpeve, te titrave mesatare gjeometrike dhe te raportit te peshes se titrave te mesem e te larte ndaj atij te ulet nga muaji Dhjetor 2000-Janar 2001.
- Rezulatet e analizave serologjike vertetuan plotesisht faktin se ne vendin tone qarkullonte virusi i gripit A/H1N1 dhe se ky virus do te behej shkak i nje epidemie te mundshme.
- Ne baze te analizave virologjike dhe serologjike ne vend dhe duke u bazuar ne rezultet e analizave te shtameve te derguara ne Qendren Nderkombtare te gripit ne Londer, rezultoi se shkaktari i epidemise se gripit ne vendin tone ishte virusi i gripit i nentipit A/H1N1, i ngjashem me A/New Caledonia/20/99 dhe A/Madagaskar/57794/00.
- Te dhenat laboratorike treguan se ky grip preku te gjithe moshat , por me te ndjeshme ndaj ketij nentipi ishin moshat femiore dhe ato te reja.
- Per te patur situaten nenkontroll duhet te vazhdohet te ndiqet ne menyre sistematike situata e gripit duke bere analiza serologjike ne sitate te qete epidemiologjike dhe ne rast epidemie te behen ekzaminime virologjike e serologjike per te percaktuar nentipin apo variantet e ndryshme te te njejtit nentip.

Studim mbi vleresimin e metodave bashkekohore serodiagnostike te sifilizit

Minella PAPAJORGJI₁, Mirela LIKA (ÇEKANI)₂

Ne Shqiperi rasti i fundit me sifiliz latent eshte diagnostikuar ne vitin 1973.

Prej kesaj periudhe deri ne vitin 1995, megjithese jane kryer rregullisht reaksionet serologjike, nuk eshte diagnostikuar asnje rast me sifiliz.

Gjate viteve 1995-2000 jane ekzaminuar 72.000 serume per sifiliz dhe jane diagnostikuar 102 raste me sifiliz primar e sekondar.

Ne kete studim vleresohen metodat e ndryshme serologjike per diagnozen e sifilizit ne 86 serume te te semureve me sifiliz: RPR, TPHA, FTA Abs dhe ELISA. Rezultatet e studimit treguan se sensibiliteti i ketyre reaksioneve ishte 96.5% per RPR, 100% per TPHA e FTA Abs dhe 90.7% per ELISA.

Key word: vleresimi, RPR, TPHA, FTA Abs, ELISA, syphilis, diagnoz.

HYRJE

Ne Shqiperi ne vitin 1973 diagnostikohet rasti i fundit me sifiliz latent, dhe prej asaj periudhe deri ne vitin 1995 nuk eshte diagnostikuar asnje rast me sifiliz te çdo forme klinike, megjithese ekzamimet serologjike jane kryer cdo vit.

Ne maj te vitit 1995 u ridiagnostikuau rasti i pare me sifiliz primar tek nje i ri i infektuar me rruge seksuale jashtë vendit.

Prej kesaj kohe deri ne fund te vitit 2000 jane diagnostikuar gjithsej 102 raste me sifilis venerian te stadt primar e sekondar.

Pas vitit 1986, per here te pare filloj kultivimi i treponemave saprofite ne terrenin selektiv Nelson si dhe ne linjat qelizore McCoy me suplement e serum fetal bovin,

si dhe kultivimin e treponemave patogene me ane te provave biologjike ne kafshe te laboratorit veçanerisht ne inokulimet intratestikulare tek minjte Hamster.

Metodat diagnostike mikrobiologjike te sifilizit ne kete kohe u permiresuan ne menyre te ndjeshme, veçanerishte ato serologjike: Reaksiione te reja filluan te futen ne praktikat laboratorike si ato te tipit te lateksit me kardiolipine jo treponematoze (VDRL,RPR), reaksionet e imunoflorescences direkt dhe indirekt (FTA Abs), reaksiioni i aglutinacionit per percaktimin e IgM ne pllaka (SPA), reaksiioni i hemoaglutinacionit pasiv (TPHA), reaksiioni i imobilizimit te treponemes Nelson-Meyer (TPI), reaksiioni imunoenzimatike (ELISA) si dhe po punohet per reaksionet e amplifikimit te ADN (PCR).

Ekspertet e Organizates Boterore te Shendetese kane rekomanduar ne vitin 1993 metodat diagnostike baze me reaksionet treponematoze dhe jo treponematoze per diagnozen e sifilizit.

Keto metoda jane te unifikuara dhe te vlefshme per te gjitha treponemat sepse studimet e kryera me mikroskopine elektronike dhe biologjine molekulare deri me sot, kane vene ne dukje strukture te njeante antigenike per trponemat, studime te cilat ende vazhdojnë.

Ne Gjinine Treponema aktualisht njihen 4-er treponema patogene shkaktare te semundjeve tek njerezit: *Treponema pallidum* subsp. *pallidum* qe shkakton sifilizin; *T. pallidum* subsp.*pertenue* qe shkakton Yaws; *T. pallidum* subsp. *endemicum* qe shkakton sifilizin endemik; dhe *T. carateum* qe

shkakton Pinten. Me shume se 6-te treponema njihen si jo patogene dhe gjenden ne kavitetin e gojes: si *Treponema denticola*, *T. pectinovor*, *T. socranski*, si dhe *T. phagedenis*, *T. refringes*, *T. minuta*, *Treponema brachyspira aalborgi* e qe jetojne ne sekrecionet gjenitale dhe qelizat epiteliale te deskua-muara si dhe, *Serpulina hyodysenteriae*, *Serpulina innoceus* te shpeshta ne zorre dhe regionin anal, vecanerisht ne homoseksualitet dhe ne te semuret me AIDS, patogeniteti i te cilave ende eshte ne studim.

Qellimi i studimit tone eshte te vleresojme metodat e ndryshme laboratorike serologjike per vendosjen e diagnozes se sakte te semundjes, si dhe te rekoman-dojme metodat me me vlore qe duhet te perdoren ne praktiken mjekesore.

Materiali dhe metoda

Ekzaminimi paralelisht 86 serume nga te semure me sifiliz primar e sekondar te grumbulluara gjate viteve 1996-2000.

Serumet e ketyre te semureve jane grumbulluar nga persona klinikisht te dyshimte per sifiliz, dhuruesit e gjakut qe kryen ne menyre te detyruar ne te gjithe vendin tone si dhe nga depistimet ne maternitetin e Tiranes dhe dispancerine obsetrik-gjinekologjike te Durrësit (gjithsej 72000 ekzamime serologjike).

Keto serume u ekzaminuan njekohesisht me reaksiionin jo treponematoze RPR (te firmes Benecton-Dickinson) dhe reaksionet treponematoze te hemoaglutina-cionit pasiv (TPHA te firmes Fujirebio),

reaksionin e imunofluorescences indirekte (FTA Abs te firmes SANOFI-Pasteur) me anti IgG e IgM me fluorescene iso-thiocyanat (FITC te firmes Dako) dhe reaksiionin Imunoenzimatik ELISA te firmes Biokit.

Te semuret me sifilis jane konsideruar te gjithe pacientet qe kishin anamneze epidemiologjike, aspektin klinik te semundjes, rezultatin pozitiv te te dhenave laboratorike si negativizimin e tyre pas mje-kimit.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Te dhenat e ekzaminimeve serologjike te 86 te semureve me sifiliz paraqiten ne tabelen e meposhtme.

Tab.1. Rezultatet serologjike te 86 personave me sifiliz:

Stadet e Sifilizit	Ra ste	Metodat diagnostike									
		RPR		TPHA		FTA Abs				ELISA	
						IgG		IgM			
		Po z	Ne g	Po z	Ne g	Po z	Neg	Poz	Neg	Poz	Neg
Sifiliz primar	7	6	1	7	0	7	0	0	7	6	1
Sifiliz sekondar	79	77	2	79	0	79	0	0	79	72	7
TOTAL	86	83	3	86	0	86	0	0	86	78	8

Shenim:

RPR eshte konsideruar pozitiv ne latex aglutinacion ne titrat e antikorpeve $>1/2$

TPHA eshte konsideruar pozitiv ne titrat e antikorpeve $> 1/100$

FTA Abs eshte konsideruar pozitiv ne imunofluorescence ne hollimin 1:5

ELISA eshte konsideruar pozitiv me cut-off ≥ 0.359

Diagozat e sifilizit dieri ne vitin 1986 eshte kryer me ane te reaksiionit jo treponematoze te fiksimit te komplementit Wassermann. Per kete reaksiuni si antigeni jane perdorur kardiolipinat te nxjerra nga zemra e kafsheve bovine. Ky antigen ka aftesi te lidhet me antikorpet e te semureve me sifiliz, cilado forme klinike e sifilizit.

Pas viti 1987 antigeni kardiolipine i cili nuk ka asgje te perbashket me treponemen eshte modifikuar me reaksionet latex aglutinacion VDRL (venereal disease Research Laboratory) dhe RPR (Rapid plasma reagin). Kiti i perdorur nga ana jone RPR te firmes Benecton-Dickinson, konsiderohen nga eksperte te OBSHse si firma me cilesi me te larte te prodhimit te antigenit.

Rezultatet tona tregojne se RPRja ka rezultuar pozitiv ne 96.5%, gje qe tregon per nje sensibilitet shume te larte. Te dhenat e autoreve te huaj tregojne per nje sensibilitet ne 80% ne sifilizin primar dhe 99% ne sifilizin sekondar dhe specificitet 98%

Ky reaksiuni duke qene jo treponematoze ka nje fallco pozitivitet ne disa semundje autoimune si Lupus erithemadotes, ne te semure me faktore reumatoid pozitiv, hipergamaglobulinemi si dhe ne nje sere semundjesh infektive si ne leptospiroze, leproze, tuberkuloz, riketcioze, malarie dhe semundja Lyma. Per arsyet e mesiperme diagnostikimi i te semureve me sifiliz me ane te antigenit kardiolipin merrej ne konsiderate kur kishim aspektin klinik dhe epidemiologjik te te dhenave te te semurit.

Nga studimi yne rezulton se reaksiioni i hemoaglutinacionit pasiv TPHA me titr antikorpesh $> 1/100$ ka rezultuar ne 100% te rasteve pozitiv per te dyja stadiet e sifilizit. Ky reaksiuni konsiderohet nga studiues te shumte si reaksiuni me sensibilitet dhe sensitivitet 99%, dhe nga kitet qe per-

doren ne praktike, ato te firmes Fujirebio-japoneze ngelen me te mirat

Eksperet e organizates boterore te shendetesise theksojne se antikorpet qe krijohen javen e pare te shfaqies se sifilizit ngelen per te gjithe jeten ne nivele shume te larta ne rast se i semuri nuk mjekohet.

Ky reaksiuni ka vlore te madhe diagnostike dhe per faktin e komfortit qe krijon

kjo metode, prandaj dhe konsiderohet si reaksiuni me me vlore per diagnostikimin e sifilizit.

Gjate ekzaminimeve te serumeve me reaksiionin FTA Abs ne konstatuan se me ane te IgM me antikorpet anti-IgM reaksionet rezultuan negativ ne te gjitha rastet, nderkohë qe me IgG reaksionet rezultuan 100% pozitive. Specialsite te huaj theksojne se reaksiuni FTA Abs pamvaresisht nga stadi i tij nuk duhet te kryhet me anti-antikorpet IgM, reaksiuni i cili eshte i vlefshem vetem ne sifilizin kongenital brenda 6-te mujorit te pare.

Reaksiuni i imunofluorescences indirekte te perdorur nga ne, te firmes Sanofi - Pasteur rezultuan ne 100% te rasteve pozitiv. Ky reaksiuni se bashku me reaksiionin e hemoaglutinacionit pasiv me te drejte nga autore te huaj konsiderohen si testet me me vlore konfirmuese te diagozes se sifilizit

Per kryerjen e reaksiionit imunoenzimatik ELISA ne perdorem kite te firmes BIOKIT-Spanje dhe rezultatet tona ishin pozitiv ne 90,7% te rasteve me sifiliz.

Rezultatet tona me te ulta te ketij reaksiuni duhet te shpjegohen me cilesine e ulet jo vetem te kitit por, edhe me veshtiresine e perqatitjes se kiteve per te cilen po punohet ende sot. Te tilla te dhena jepen dhe nga autore te huaj. Ky reaksiuni qe ne parim duhet te kete sensibilitet dhe sensitivitet shume te larte, ende ne praktiken e perditeshme nuk po hyn si test konfirmues.

Ne rast se reaksiuni RPR rezulton negativ

dhe reaksiuni TPHA gjithashtu negativ, atehere nuk kemi te bejme me sifiliz. Kryerja e reaksioneve te tjera nuk eshte e nevojshme.

Ne rast se RPR rezulton pozitiv dhe TPHA negative atehere duhet kryer reaksiuni i FTA Abs dhe reaksiuni i imobilizimit te treponemes me Nelson-Meyer (TPI), reaksiuni qe kryhet vetem ne laboratoret shume te specializuar.

Ne rast se RPR eshte pozitiv dhe TPHA pozitiv atehere kemi te bejme me sifiliz. Ne keto raste konfirmimi mund te vazhdoje te kryhet duke kryer reaksiuin FTA Abs.

Ne rast se reaksiuni RPR rezulton negativ dhe i semuri dyshohet per sifiliz, vecanerisht sifiliz latent, ku niveli i antikorpeve me ane te reaksiunit RPR si rregull rezulton negativ, atehere duhet kryer edhe reaksiunet FTA Abs, ELISA dhe reaksiuni Nelson-Meyer (TPI).


Aktualisht, aplikimi gjeresisht i antibiotikeve te ndryshem modifikon shume jo vetem kliniken e te semurit por edhe ul nivelin e antikorpeve ne te semuret me sifiliz, gje qe duhet te kihet parasysh.

